## STATUTI I SHOQËRISË

## " MËRKURI" sh.p.k.

## ( ORTAK I VETËM)

### FORMIMI

**Neni1**

Formohet shoqëria tregtare me emërtimin " MËRCURI" sh.p.k. me ortak të vetëm , Eduart Poda, i biri Shpëtimit, lindur më 1968, banues në Tiranë në Rrg. " Mati Logoreci " pll. 10.

### SELIA E SHOQËRISË

**Neni 2**

Selia e shoqërisë është në Tiranë, në Rrg. " Mati Logoreci" pll.10. Shoqëria mund të hapë dhe vënd qëndrime të tjera të dyta operative, filjale , përfaqsi në të gjithë teritorin e vëndit.

### KOHË ZGJATJA

**Neni 3**

Kohë zgjatja e veprimtarisë ekonomike është mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërbëhte në çdo kohë.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

**Neni 4**

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë " MËRCURI"sh.pk. është përsa vijon:

- Argëtimi i të rinjëve me lojra elektronike, fati, bar - kazino.

Si dhe çdo aktivitet tjetër që veças ose së bashku me ato të përmëndura më sipër do të ndikojë në zhvillimin e shoqërisë.

**Neni 5**

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, vënd qëndrimin si dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë pronari i saj.

### KAPITALI I SHOQË RISË

**Neni 6**

E Poda

Neni 6

Kapitali i shoqërisë është 100.000lek. i formuar në masë të plotë nga ortaku i vetëm.

Neni 7

Kapitali shoqërisë mund të shtoeht ose mund të paksohet sipa vendimeve që merr ortaku i vetëm dhe merret i miratuar dhe i mënshkr ar prej tij.

DREJTIMI I DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria private " MËRCURI "sh;P;K. deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të norma ve që përmban ky statut dhe ato të legjislacionit shqiptar. Shoqëria private , fiton zotësinë për të vepruar me rregjistrimin e saj si person juridik në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe ndërsa ushtron aktivitetim privat me rregjistrimin në Zyrën e Tatimeve.

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen " SHOQËRIA MËRCURI sh.p. k. TIRANË".

Neni 10

Shoqëria private " MËRCURI"sh.p;k. vepron në rregjimin e pronës private dhe merrë përsipër vetë të drejtat e detyrimet. Ajo përgjigjet vetë për detyrimet e saj kontraktore e jashtë kontraktore brënda kapitalit të saj. Pronari i shoqërisë bart rezikun e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e shumës së mjeteve të investu ara në shoqëri.

Neni 11

Shoqëria është e krijuar nga Edmond Poda , themelues i saj. Ai merr vendime në zbatim të ligjeve në fuqi dhe sipas këtij statuti të cilat janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit në këtë shoqëri.

Neni 12

Ortaku i vetëm , sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtaris së shoqërisë , emëron Administrator si dhe punëson

punojës të ndryshëm në aktivitetet e ndryshme ekonomike të përmëndura në nenin katër të këtij statuti.

## Neni 13

Ortaku i vetëm dhe Administratori i ngarkuar prej tij janë të veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtzakonshëm të shoqërisë, pa asnjë lloj kufizimi. Ata kanë mundësi të kryejnë të gjitha aktet që konsiderojnë të nevojshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë . Ata kanë të drejtë , midis të lidhen me shoqëri të tjera të vëndit apo të huaja, të kryejnë pranë insitutev ve bankare e financjare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arkëtime. Në këto raste Adminsitratori i ngarkuar ka për detyrë të njoftojë dhe ti japë llogari ortakut të vetëm.

## Neni 14

Përfaqsimi i shoqërisë , i përket ortakut të vetëm dhe Administratorit të ngarkuar prej tij . Ata kanë të drejtën e përfaqsimit në organet gjyqësore e gjykime të caktojnë e të pushojnë avokat.

## BILANCI DHE TË ARDHURAT

## Neni 16

Veprimet ekonomike të shoqërisë dhe ato financjare mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo perjudhe ushtrimore , Administratori nxjerrë bilancin kontabël të shoqërisë me rezultatin FITM HUMBJE, mbështetur në ligje dhe rregulla të mbajtjes së kontabilitetit nga subjektet private përcaktuar nga organet kompetente t të sistemit fiskal. Bilanci konta bël mirtaohet nga ortaku i vetëm i cili vendos për krijimin e fondeve të ndryshme të nevojshme për garancinë e veprimtaris së shoqërisë, di fondin e akomulimit, fondin rezervë etj.

## Neni 17

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve ligjore të përmëndura më sipër dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimi i mbesin për pë rdorim ~~xxxxxxxxx~~ ortakut të vetëm.

## SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

### Neni 18

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe përçfardo shkaku si humbja e kapitalit, pa mundësi veprimtarie etj. Në këto raste pronari i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë. Këta bëjnë kujdes që shoqëria të likujdoj më parë detyrimet që ajo ju ka personave të tretë fizikë e juridike.

## DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

### Neni 19

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve nga ortaku i vetëm si dhe ligjeve përkatse shqiptare.

### Neni 20

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kopetente ndërsa një kopje mbetet si pjesë përbërse e dokumentacionit të themelim it të shoqërisë .

ORTAKU I VETËM

EDUART PODA

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË

" MËRCURI " sh.p;k.

( ORTAK I VETËM)

Sot, më datë 29.X.1993 , unë i quajturi Eduart Poda Themeloj shoqërinë si ortak i vetë të emërtuar " MERCURI"sh.p.k.

Neni 1

Selia e shoqërisë ë shtë në Tiranë në Rrg." Mati Logoreci" pll.10 .

Neni 2

Kohë zgjatja e veprimtaris së shoqërisë është mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërmëhet në çdo; kohë.

Neni 3

Kapita li i shoqërisë është 100.000lekë i formuar në masë të plotë nga ortaku i vetëm.

Neni 4

Aktiviteti i shoqërisë është:

Argëtimi i të rinjve me lojra elektronike, fati dhe bar - kazino.

ORTAKU I VETËM

EDUART PODA